

Fondi Slloveno Kosovar i Pensioneve Sha  
Kompania

PASQYRAT FINANCIARE

PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2019

ME RAPORTIN E AUDITORIT TË PAVARUR

## Përmbajtja

	Faqe
Raporti i auditorit të pavarur	1
Pasqyra e pozicionit finansiar	3
Pasqyra e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave tjera gjithëpërfshirëse	4
Pasqyra e ndryshimeve në ekuitet	5
Pasqyra e rjedhës së parasë	6
Shënime për pasqyrat financiare	7-21



RSM KOSOVO SH.P.K

Str. Perandori Justinian 62  
Qyteta Pejton  
10 000 Prishtina  
Republic of Kosovo

T +381 38 609 900  
F +381 38 609 901  
DL +377 45 666 888

[www.rsmks.com](http://www.rsmks.com)

## RAPORTI I AUDITORIT TË PAVARUR

Për Aksionarët dhe Menaxhmentin e "Fondi Slloveni Kosovar i Pensioneve Sh.a"

### Opinion

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Fondi Slloveni Kosovar i Pensioneve Sh.a ("Kompania"), të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financier me datën 31 Dhjetor 2019, pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në neto pasuritë për vitin e përfunduar me këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përbledhje të politikave të rëndësishme të kontabilitetit.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financier të më 31 Dhjetor 2019 dhe performancën e saj financiare për vitin e përfunduar me këtë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

### Baza për Opinionin

Ne kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISA) dhe udhëzimet administrative nr 02/2019 pér pavarësinë e auditorëve ligjor dhe firmave të auditimit të lëshuara nga Republika e Kosovës. Përgjegjësitë tona nën këto standarde përshkruhen më tej në Përgjegjësitë e Auditorit pér Auditimin e Pasqyrave Financiare të raportit tonë. Ne besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme pér të siguruar një bazë pér opinionin tonë. Ne jemi të pavarur nga Kompania në përputhje me Kodin e Etikës pér Profesionistët Kontabël të Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të Etikës pér Profesionistët Kontabël (Kodi i BSNEK), dhe ne kemi përbushur përgjegjësitë tona të tjera etike në përputhje me udhëzimet administrative nr 02/2019 dhe Kodin IESBA. Ne besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme pér të siguruar një bazë pér opinionin tonë.

### Çështjet kryesore të auditimit

Çështjet kryesore të auditimit janë ato çështje që, sipas gjykimit tonë profesional, kishin më shumë rëndësi në auditimin tonë të pasqyrave financiare. Çështjet kryesore të auditimit janë përzgjedhur nga çështjet e komunikuara me personat e ngarkuar me qeverisjen por nuk kanë pér qëllim të përfaqësojnë të gjitha çështjet që u diskutuan me ta. Procedurat tona të auditimit në lidhje me këto çështje janë hartuar në kontekstin e auditimit tonë të pasqyrave financiare në tërësi. Opinion i ynë pér pasqyrat financiare nuk është modifikuar në lidhje me ndonjë nga çështjet kryesore të auditimit të përshkruara më poshtë, dhe ne nuk shprehim një opinion individual pér këtë çështje.

THE POWER OF BEING UNDERSTOOD  
AUDIT | TAX | CONSULTING

## Vlerësimi i pasurive financiare

Më 31Dhjetor 2019, Kompania mbajti investime të cilat nuk ishin kuotuar në një treg aktiv me një vlerë të drejtë prej EUR 232,521 (31 dhjetor 2019:226,220), të cilat përfshihen në pasuritë financiare me vlerë të drejtë përmes të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse. Në thelb këto pasuri janë më të vështira për tu vlerësuar, pasi ato nuk kanë çmime të kuotuara në dispozicion të publikut nga një treg aktiv, dhe si të tilla ato kërkojnë gjykim profesional ose supozime që duhen bërë kur t'i vlerësoni ato në fund të vitit. Përcaktimi i vlerave të drejta bëhet duke përdorur rendimentet më të fundit të publikuara për obligacione me maturitet të ngjashëm të mbetur.

Ne kemi ndërmarrë punën e mëposhtme në lidhje me këtë rrezik:

- verifikimi i informacionit të dhënë në konfirmimin e mbajtësit të obligacionit kundër bilanceve të llogarisë përkatëse dhe rekonsilimi i vlerave të raportuara në Pasqyrën e Pozicionit Financiar me të dhënat përkatëse të kontabilitetit, dhe
- verifikimi i hyrjes (rendimentit) të përdorur në llogaritjen e burimeve të jashtme dhe rilogaritja e vlerave të drejta

**Përgjegjësitet e Menaxhmentit dhe Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në lidhje me Pasqyrat Financiare**  
Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar, dhe për ato kontolle të brendshme që menaxhmenti i gjykon të nevojshtje për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përbajnë gabime materiale, qoftë për shkak të mashtimit apo pasaktësive.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, menaxhmenti është përgjegjës për të vlerësuar aftësishnë e Kompanisë për të kryer veprimtarinë në vijmësi, duke vënë në dispozicion informacione për çështje që kanë të bëjnë me vijueshmërinë e aktivitetit, nëse është e zbatushme, përvèç rasteve kur menaxhmenti synon të ndërpres aktivitetin, ose nuk ka alternative tjetër reale përvèç se më sipër.

Personat e ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Kompanisë.

### **Përgjegjësitet e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare**

Objektivat tona janë që të arrjmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë gabime materiale, qoftë për shkak të mashtimit apo të pasaktësive, dhe të lëshojmë një raport auditimi përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një gabim material kur ai ekziston. Gabimet mund të vijnë si rezultat i gabimit apo i pasaktësive dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykinin dhe ruajmë skepticizm profesional gjatë gjithë periudhës së auditimit. Gjithashtu ne:

- identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e gabimeve materiale në pasqyrat financiare, si rezultati i mashtimeve apo pasaktësive, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen këtyre rreziqeve, si dhe sigurojmë të dhëna të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit, në mënyrë që të shërbjnë si bazë për opinionin tonë. Rreziku i mosbulimit të një gabimi si pasojë e mashtimit është më i lartë se rreziku i mosbulimit të një gabimi si pasojë e pasakatësisë, për shkak se, mashtimi mund të përfshijë një marrëveshje të fshehtë, falsifikim, mosveprim të qëllimshëm, keqinterpretim, apo shkelje të kontrollit të brendshëm
- marrim një kuptueshmëri të atyre kontolleve të brendshme relevante për procesin e auditimit, me qëllim hartimin e procedurave të auditimit në përputhje me rrethanat, por jo për të shprehur një opinion mbi efektivitetin e kontolleve të brendshme të Kompanisë.

- vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve kontabël, si dhe shënimëve shpjeguese të pregititura nga Menaxhmenti.
- japid përfundime mbi përshtatshmërinë e parimit kontabël të vijimësisë së veprimtarisë të përdorur nga Menxhmenti dhe bazuar në evidencat e siguruara të auditimit, nëse ka një pasiguri materiale mbi aftësinë e Kompanisë për të vijuar veprimtarinë. Në rast se arrijmë në përfundim se një pasiguri materiale ekziston, ne duhet të térheqim vëmendjen në shënimin shpjegues përkatës, nëpërmjet raportit tonë të auditimit, ose nëse shënimet shpjeguese nuk janë të përshtatshme ne duhet të modifikojmë opinionin tonë. Konkluzionet tona janë të bazuara në evidencat e siguruara të auditimit të marra deri në ditën e lëshimit të raportit të auditorit. Megjithatë, ngjarjet ose kushtet në të ardhmen, mund të shkaktojnë ndërprerjen e vijimësisë së veprimtarisë së Kompanisë.
- vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përbajtjen e pasqyrave financiare dhe të shënimëve shpjeguese dhe nëse pasqyrat financiare paraqesin veprimet dhe ngjarjet në mënyrë të atillë që siguron paraqitjen e drejtë

Ne komunikojmë me personat e ngarkuar me qeverisjen e kompanisë, ndër çështje të tjera, në lidhje me qëllimin dhe afatet e planifikuar të auditimit si dhe gjetjet e rëndësishme të konstatuara gjatë auditimit, përfshirë mangsitë e rëndësishme në sistemin e kontrollit të brendshëm që identifikojmë gjatë auditimit tonë.

Ne gjithashtu i sigurojmë komitetit të kontrollit dhe bordit mbikëqyrës një deklaratë që ne kemi zbatuar kërkesat përkatëse etike në lidhje me pavarësinë, dhe për të komunikuar me ata të gjitha marrëdhëniet dhe çështjet e tjera që në mënyrë të arsyeshme mund të mendohet se mbajnë pavarësinë tonë, dhe aty ku është e zbatueshme, mbrojtjet përkatëse.

Nga çështjet e komunikuara me komitetin e auditimit dhe bordin mbikëqyrës, ne përcaktojmë ato çështje që kishin më shumë rëndësi në auditimin e pasqyrave financiare të periudhës aktuale dhe për këtë arsyе janë çështjet kryesore të auditimit

#### Kërkesa të tjera për përbajtjen e raportit të auditorit në përputhje me Ligjin 06 / L-032

Ne u caktuam nga aksionari në mbledhjen e datës 29 Mars 2019 për të audituar pasqyrat financiare të Fondit për vitin që përfundon më 31 Dhjetor 2019. Angazhimi ynë i pandërprerë i plotë është 2 vite, duke përfshirë periudhën që përfundon më 31 Dhjetor 2018.

Ne konfirmojmë se:

- Opinion i auditimit për pasqyrat financiare të shprehura këtu është në përputhje me reportin shtesë për komitetin e auditimit të Kompanisë, të cilën e lëshuan më 27 shkurt 2020.
- Asnjë shërbim i ndaluar jo-auditimi i përmendor në nenin 5 (1) të udhëzimit administrativ nr. 02/2019 nuk është ofruar nga ne për Kompaninë.

*Ky rapport është përkthim i versionit original në gjuhën angleze, në rast të mospërputhjeje midis këtyre raporteve, rapporti në gjuhën angleze do të mbizotërojë.*

*RSM Kosovo Sh.p.k.*

RSM Kosovo Sh.p.k

Prishtinë, Kosovë

28 Shkurt 2020



Astrit Kelmendi

Auditor ligjor

**THE POWER OF BEING UNDERSTOOD**  
AUDIT | TAX | CONSULTING

**FONDI SLOVENO KOSOVAR I PENSIONEVE - KOMPANIA**  
**DEKLARATA E POZICIONIT FINANCIAR**  
**Me 31 Dhjetor 2019**  
*(Shumat në EUR, përveç nëse përcaktohet ndryshe)*

	Shënimet	Më 31 Dhjetor 2019	Më 31 Dhjetor 2018
<b>PASURITË</b>			
Paraja dhe Ekuivalitet e parase	4	55,522	19,954
Pasuritë financiare me vlerë të drejtë përmes pasqyrës së të ardhurave gjithëpërfsirëse	5	406,785	397,368
Prona dhe Pajisjet	6	9,132	7,276
Pasuritë e paprekshme	6	14,444	-
Të arkëtueshmet dhe pasuritë tjera	7	21,441	18,679
Parapagimet e tatimit		224	1,442
<b>GJITHSEJ PASURITË</b>		<b>507,548</b>	<b>444,719</b>
<b>DETYSIMET</b>			
Tregtia dhe detyrimet e tjera	8	40,239	12,331
Detyrimi i qirasë financiare	9	1,462	299
<b>GJITHSEJ DETYRIMET</b>		<b>41,701</b>	<b>12,630</b>
<b>KAPITALI</b>			
Kapitali Aksionar	10	400,000	400,000
Rezervat e rivlerësimit		12,743	7,338
Fitimet e mbajtura		53,104	24,751
<b>GJITHSEJ KAPITALI</b>		<b>465,847</b>	<b>432,089</b>
<b>GJITHSEJ DETYRIMET DHE KAPITALI</b>		<b>507,548</b>	<b>444,719</b>

Këto pasqyra financiare janë miratuar nga Menaxhmenti i Fondi Slovено Kosovar i Pensioneve Sh.a - më 31 Janar 2020  
dhe nënshkruar në emër të tij nga,

Mr. Bajram Bajrami,  
Drejtëor menaxhues

Shaqetë Aksionare - Prishtina

FONDI  
SLOVENO-KOSOVAR  
I PENSIONEVE

Pasqyra e mësipërme e pozicionit finansiar duhet të lexohet së bashku me shënimet shoqëruese.

**FONDI SLLOVENO KOSOVAR I PENSIONEVE SHA - KOMPANIA**  
**PASQYRA E FITIMIT OSE HUMBJES DHE TË ARDHURAVE TJERA GJITHËPËRFSHIRËSE**  
**Për vitin që përfundoi më 31 Dhjetor 2019**  
*(Vlerat në EUR, përvèç nëse përcaktohet ndryshe)*

	Shënimet	2019	2018
<b>TË ARDHURAT</b>			
Tarifa e Menaxhimit nga Fondi 1		112,726	105,098
Tarifa e Menaxhimit nga Fondi 2		6,968	6,189
Tarifa e hyrjes		16,383	15,341
Tarifa e daljes		4,060	4,551
Të ardhurat nga interesë	11	10,348	12,258
<b>NETO TË ARDHURAT</b>		<b>150,485</b>	<b>143,437</b>
<b>SHPENZIMET</b>			
Shpenzimet operative	12	(118,583)	(119,419)
Shpenzimet e interesit		(182)	(229)
Dëmtimet		32	(205)
<b>GJITHSEJ SHPENZIMET</b>		<b>(118,733)</b>	<b>(119,853)</b>
Fitimi para tatimit		31,752	23,584
Shpenzimet e tatimit në të ardhura	13	(3,160)	(2,450)
<b>Fitimi i vitit</b>		<b>28,592</b>	<b>21,134</b>
<b>Te ardhurat tjera gjithëpërfshirëse:</b>			
<i>Artikujt që mund të klasifikohen si fitim ose humbje</i>			
Ndryshimet neto në vlerën e drejtë në pasuri financiare përmes FVOCI		5,405	(6,489)
<b>GJITHSEJ TË ARDHURAT TJERA</b>		<b>33,997</b>	<b>14,645</b>
<b>GJITHËPËRFSHIRËSE</b>			

Pasqyra e mësipërme e të ardhurave gjithëpërfshirëse duhet të lexohet së bashku me shënimet shoqëruese

**FONDI SLLOVENO KOSOVAR I PENSIONEVE SHA - KOMPANIA  
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË EKUITET**

**Për vitin që përfundoi më 31 Dhjetor 2019**  
(Vlerat në Euro, përvèç nëse theksohet ndryshe)

	Kapitali Aksionar	Rezervat e Rivlerësimit	Fitimet e Mbajtura	Gjithsej
<b>Më 1 JANAR 2019</b>	<b>400,000</b>	<b>7,338</b>	<b>24,751</b>	<b>432,089</b>
<u>Transaksionet me pronarin</u>				
Ndryshimet në Politikën e kontabilitetit	-	-	(239)	(239)
Gjithsej transaksionet me pronarin dhe efekti në ndryshimin e kontabilitetit	-	-	(239)	(239)
Fitimi i vtit			28,592	28,592
Humbje të tjera gjithëpërfshirëse	-	-	-	-
<b>GJITHSEJ TË ARDHURAT</b>		<b>5,405</b>	<b>28,592</b>	<b>33,997</b>
<b>GJITHËPËRFSHIRËSE</b>				
<b>Më 31 DHJETOR 2019</b>	<b>400,000</b>	<b>12,743</b>	<b>53,104</b>	<b>465,847</b>
<b>Më 01 JANAR 2018</b>	<b>400,000</b>	<b>13,827</b>	<b>93,617</b>	<b>507,444</b>
<u>Transaksionet me pronarin</u>				
Dividenta e deklaruar	-	-	(90,000)	(90,000)
Gjithsej transaksionet me pronarin	-	-	(90,000)	(90,000)
Fitimi i vtit	-	-	21,134	21,134
Humbje të tjera gjithëpërfshirëse	-	(6,489)	-	(6,489)
<b>GJITHSEJ TË ARDHURAT</b>		<b>(6,489)</b>	<b>21,134</b>	<b>14,645</b>
<b>GJITHËPËRFSHIRËSE</b>				
<b>Më 31 Dhjetor 2018</b>	<b>400,000</b>	<b>7,338</b>	<b>24,751</b>	<b>432,089</b>

Pasqyra e mësipërme e ndryshimeve në ekuitet duhet të lexohet së bashku me shënimet shoqëruese.

**FONDI SLLOVENO KOSOVAR I PENSIONEVE – KOMPANIA  
PASQYRA E RRJEDHJËS SË PARASË**

**Për vitin që përfundoi më 31 dhjetor 2019**

(Vlerat në Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

	Shënimet	2019	2018
<b>AKTIVITETET OPERATIVE</b>			
Fitimi para tatimit mbi të ardhurat	31,752	23,584	
Korigjuar për:			
Zhvlerësimi dhe Amortizimi	8,091	4,594	
Të ardhurat nga intereseti	(10,348)	(12,258)	
Shpenzimet e interesit	182	229	
Dëmtimet	(32)	205	
<i>Të ardhurat operative para ndryshimeve në aktivitetet operative</i>	<b>29,645</b>	<b>16,354</b>	
Ndryshimet në kapitalin punues:			
Të arkëtueshmet dhe pasuritë tjera	(2,762)	3,234	
Tregtia dhe detyrimet tjera	27,908	2,331	
Interesi i pranuar	9,731	14,858	
Interesi i paguar	(203)	(229)	
Pagesa e tatimit mbi të ardhurat	(2,155)	(3,438)	
<b>Paratë e gjeneruara nga aktivitetet operative</b>	<b>62,164</b>	<b>33,110</b>	
<b>AKTIVITETET INVESTIVE</b>			
Ndryshimet e investimeve ne FVOCl	(3,367)	30,850	
Blerja e pajisjeve, impiante dhe pajisje jo-materiale	(24,391)	(7,267)	
<b>Paratë e gatshme të përdorura për aktivitete investuese</b>	<b>(27,758)</b>	<b>23,583</b>	
<b>AKTIVITETET FINANCUESE</b>			
Dividenta e paguar	-	(90,000)	
Detyrimi i qirasë financiare	1,162	(3,382)	
<b>Paratë e përdorura nga aktivitetet e financimit</b>	<b>1,162</b>	<b>(93,382)</b>	
<b>NDRYSHIMET NË PARA TË GATSHME DHE EKUIVALENTËT E PARASË</b>			
Paraja dhe ekuivalentët e parasë në fillim të periudhës	35,568	(36,689)	
<b>PARAJA DHE EKUIVALENTËT E PARASË NË FUND TË PERIUDHËS</b>	<b>4</b>	<b>19,954</b>	<b>56,643</b>
		<b>55,522</b>	<b>19,954</b>

Pasqyra e mësipërme e rrjedhës së parasë duhet të lexohet së bashku me shënimet shoqëruese

**FONDI SLLOVENO KOSOVAR I PENSIONEVE SHA - KOMPANIA**  
**SHËNIMET PËR PASQYRAT FINACIARE PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2019**  
(Vlerat në Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

## 1. Informacione të përgjithshme

Fondi i Slloveno Kosovar i Pensioneve Sh.a. (më tutje referuar si "Kompani" ose "FSKP") është themeluar si shoqëri aksionare më 29 Gusht 2006 me numër regjistrimi të biznesit 70378739. Kompania ka filluar veprimitarë e saj më 4 Shtator 2006. Zyra e regjistruar ndodhet në Rr. Ukshin Hoti, nr.45/10, 10000, Prishtinë, Republika e Kosovës.

Aksionarët kryesorë të Kompanisë janë Prva Group PLC, e cila është themeluar në Slloveni me pronësi të 67.4% të aksioneve dhe Korporata Dukagjini në Kosovë me 32.6% të aksioneve. Kompania e fundit amë është kompania sllovene A-Z Finance d.o.o.

Veprimitarët kryesore e Kompanisë janë si në vijim: menaxhimi i fondeve pensionale, përfaqësimi i tyre para palëve të treta dhe të gjitha aktivitetet e tjera të lidhura me fondeve pensionale.

Që nga fillimi i saj e deri në fillim të vitit 2008, Kompania ka menaxhuar një fond pensional vullnetar (më tutje referuar si "Fondi 1"). Gjatë vitit të përfunduar më 31 Dhjetor 2008, Kompania ka nënshkruar marrëveshje me kompaninë PTK fondin në likuidim të sigurimit pensional plotësues (më tutje referuar si "PTK"), për menaxhimin të pasurive të tyre dhe pagesën e pensionit vjetor në çdo muaj sipas planeve të paracaktuara të pensioneve të ofruar nga PTK. Pasuritë e PTK përbëjnë fondin e dytë pensional nën menaxhimin e FSKP (më tutje referuar si "Fondi 2 dhe gjithashu kontribuesit e transferuar nga Fondi 1 pas moshës së pensionit.

## 2. Politikat e Rëndësishme të Kontabilitetit

Politikat kryesore të kontabilitetit të miratuara për përgatitjen e këtyre pasqyrave financiare janë paraqitur më poshtë. Këto politika janë zbatuar në mënyrë të vazhdueshme në të gjitha vitet e paraqitura, përveç nëse është theksuar ndryshe.

### Bazat e Përgatitjes

Këto pasqyra financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) të nxjerra nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit. Pasqyrat financiare janë përgatitur në bazë të parimit të vijueshmërisë.

Këto pasqyra financiare janë përgatitur duke përdorur politikat e rëndësishme të kontabilitetit dhe bazat e matjes të përbledhura më poshtë. Këto politika janë aplikuar në vazhdimësi në të gjitha vitet e paraqitura, përveç nëse caktohet ndryshe.

Këto pasqyra financiare duhet të lexohen ashtu siç janë përgatitur në përputhshmëri me standardet dhe rregulloret e kontabilitetit Gjithashu, kërkon që menaxhmenti të vlerësojë procesin e zbatimit të politikave të kontabilitetit.

Këto pasqyra financiare janë paraqitur në Euro, monedha e Bashkimit Evropian.

### Standardet dhe interpretimet efektive në periudhën aktuale

Kompania ka miratuar të gjitha Standardet dhe Interpretimet e reja ose të ndryshuara të Kontabilitetit të publikuara nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit ("BSNK") të cilat janë efektive për periudhën raportuese aktuale.

Çdo standard i ri ose i ndryshuar i kontabilitetit që nuk është ende i detyrueshëm nuk është implementuar menjëherë. Standardet dhe Interpretimet më të rëndësishme për Kompaninë janë paraqitur në vijim:

### SNRF 16 Qira

Standardi zëvendëson SNK 17 'Qira' dhe për qiramarrësit eliminon klasifikimin e qirave operative dhe qirave financiare. Me përjashtim të qirave afatshkurtra dhe qirave të pasurive me vlerë të ulët, pasuritë me të drejtë përdorimi dhe detyrimet përkatëse të qirasë njihen në pasqyrën e pozicionit financiar. Njohja e shpenzimeve të qirasë operative në linjë të drejtpërdrejtë zëvendësohet me një tarifë zhvlerësimi për pasuritë me të drejtë përdorimi (përfshirë në kostot operative) dhe një shpenzim interesit për detyrimet e njohura të qirasë (përfshirë në kostot e financimit). Në periudhat e mëparshme të qirasë, shpenzimet që lidhen me qiranë sipas SNRF 16 do të janë më të larta kur krasohen me shpenzimet e qirasë nën SNK 17. Sidoqoftë, rezultatet e EBITDA (Fitimet Para Interesit, Taksave, Zhvlerësimit dhe Amortizimit) përmirësohen pasi shpenzimi operativ është tani zëvendësuar nga shpenzimet e interesit dhe zhvlerësimi në fitim ose humbje. Për klasifikimin brenda pasqyrës së rjedhës të parastë, pjesa e interesit shpaloset në aktivitetet operative dhe pjesa kryesore e pagesave të qirasë shpaloset veçmas në aktivitetet e financimit. Për kontabilitetin e qiradhënësit, standardi

**FONDI SLLOVENO KOSOVAR I PENSIONEVE SHA - KOMPANIA**  
**SHËNIMET PËR PASQYRAT FINACIARE PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2019**  
(Vlerat në Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

nuk ndryshon në mënyrë thelbësore se si një qiradhënës llogarit me qira. Standardi i ri nuk ka ndikuar në pasqyrat financiare të fondit.

**Standarde dhe Interpretimet e lëshuara por ende jo efektive**

Standarde e kontabilitetit që janë lëshuar ose ndryshuar kohët e fundit, por nuk janë akoma të detyrueshme, nuk janë miratuar më herët nga fondi për periudhën raportuese që përfundoi më 31 Dhjetor 2019. Kompania nuk ka vlerësuar ende ndikimin e këtyre Standardeve dhe Interpretimeve të Kontabilitetit të reja ose të ndryshuara

**Pasuritë financiare**

**Klasifikim**

Kompania ka klasifikuar pasuritë e saj financiare në kategoritë e mëposhtme të matjes:

- ato që duhet matur më pastaj me vlerë të tregut (qoftë përmes OCI ose përmes fitimit ose humbjes),  
dhe
- ato që duhet matur me kosto të amortizuar.

Klasifikimi varet nga modeli i biznesit të njësisë ekonomike për menaxhim të pasurive financiare dhe kushteve kontraktuale të rrjedhës së parasë. Kompania riklasifikon investimet e borxhit atëherë dhe vetëm atëherë kur modeli i saj i biznesit për menaxhimin e këtyre pasurive ndryshon.

**Njohja dhe mosnjohja**

Blerjet dhe shitjet e rregullta të pasurive financiare njihen në datën e tregtimit, datën në të cilën Kompania angazhohet të blejë ose shet pasurinë. Mosnjohja e pasurive financiare atëherë kur të drejtat për të pranuar rrjedhën e parasë nga pasuritë financiare ka skaduar ose ato janë transferuar dhe Kompania kryesisht ka transferuar të gjitha rreziqet dhe të drejtës së pronësisë.

**Matja**

Gjatë njohjes fillestare, Kompania mat një pasuri financiare me vlerë të saj të tregut plus, në rastin e një pasurie financiare me vlerë jo të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes (FVPL), kostot e transaksionit të ndërlidhura drejtpërdrejt me blerjen e pasurisë financiare. Kostot e transaksionit të pasurive financiare të mbajtura në FVPL janë shpenzuar në fitim ose humbje.

Pasuritë financiare me derivativat e lidhur merren në konsideratë si tërësi, për të përcaktuar nëse rrjedhën e tyre të parasë e përbëjnë vetëm pagesa e kryegjësë dhe interesit.

**Instrumentet e borxhit**

Matja e mëpasshme e instrumenteve të borxhit varet nga modeli i biznesit i Kompanisë për menaxhimin e pasurisë dhe karakteristikat e rrjedhjes së parasë së pasurisë. Ekzistojnë tre kategori të matjes, përmes së cilave Kompania i klasifikon instrumentet e saj të borxhit:

- Kostoja e amortizuar: Pasuritë që mbahen për mbledhjen e flukseve monetare kontraktuale, kur ato flukse monetare përfaqësojnë vetëm pagesa të principalit dhe kamatës maten me koston e amortizuar. Të ardhurat nga intereseti nga këto pasuri financiare përfshihen në të ardhurat nga financimi duke përdorur metodën efektive të normës së interesit. Çdo fitim ose humbje që vjen nga çregjistrimi njihet drejtpërdrejt në fitim ose humbje dhe paraqitet në fitime / (humbje) të tjera, së bashku me fitimet dhe humbjet e këmbimit valutor. Humbjet nga zhvlerësimi paraqiten si zëra të veçantë në pasqyrën e fitimit ose humbjes. Me 31 Dhjetor 2019, arkëtimet për tarifë administrimi klasifikohen në këtë kategori.
- FVOCl: Pasuritë që mbahen për mbledhjen e flukseve monetare kontraktuale dhe për shitjen e pasurive financiare, ku flukset e parave të pasurive përfaqësojnë vetëm pagesa të principalit dhe interesit, maten në FVOCl. Lëvizjet në vlerën kontabel merren përmes OCI, përveç njohjes së fitimeve ose humbjeve nga zhvlerësimi, të ardhurat nga intereseti dhe fitimet dhe humbjet nga këmbimi i huaj që njihen në fitim ose humbje. Kur pasuria financiare është çregjistruar, fitimi ose humbja kumulative e njohur më parë në OCI riklasifikohet nga kapitali neto në fitim ose humbje dhe njihet në fitime / (humbje) të tjera. Të ardhurat nga intereseti nga këto pasuri financiare përfshihen në të ardhurat nga financimi duke përdorur metodën efektive të normës së interesit. Fitimet dhe humbjet e këmbimit valutor paraqiten në fitime / humbje të tjera dhe

**FONDI SLLOVENO KOSOVAR I PENSIONEVE SHA - KOMPANIA**  
**SHËNIMET PËR PASQYRAT FINACIARE PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2019**  
(Vlerat në Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

shpenzimet e zhvlerësimit paraqiten si zë i veçantë i linjës në pasqyrën e fitimit ose humbjes. Me 31 Dhjetor 2019 ka pasuri financiare me vlerë të drejtë përmes të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse, klasifikohen në këtë kategori.

- FVPL: Pasuritë që nuk plotësojnë kriteret për koston e amortizuar ose FVOCL maten në FVPL. Një fitim ose humbje nga një investim i borxhit që matet më pas në FVPL njihet në fitim ose humbje dhe paraqitet Brenda neto fitimeve / (humbjeve) të tjera në periudhën në të cilën lind. Me 31 Dhjetor 2019, pasuria financiare me vlerë të drejtë përmes fitimit dhe humbjes klasifikohet në këtë kategori.

## 2. Politikat e Rëndësishme të Kontabilitetit (Vazhdim)

### *Instrumentet e ekuitetit*

Kompania më pastaj ka matur të gjitha investimet e kapitalit neto me vlerën e tregut. Atëherë kur menaxhmenti i Kompanisë ka përzgjedhur që të paraqesë fitimet dhe humbjet sipas vlerës së tregut në investimet e kapitalit në OCI, nuk ka pasur riklasifikim të mëvonshëm të fitimeve ose humbjeve sipas vlerës së tregut në fitim ose humbje pas çregjistrimit të investimit. Dividentat nga investimet e tilla vazhdojnë të nijhen në fitim ose humbje si të ardhura nga dividentat kur vendoset e drejta e Kompanisë për të marrë pagesa.

Ndryshimet në vlerën e tregut të pasurive financiare në FVPL nijhen në ndryshimet neto në vlerën e tregut të pasurive financiare me vlerë të tregut, nëpërmjet fitimit ose humbjes në pasqyrën e fitimit ose humbjes sipas rastiit. Humbjet nga zhvlerësimi (dhe anulimi i humbjeve nga zhvlerësimi) për investimet e kapitalit të matura në FVOCL nuk raportohen veçmas nga ndryshimet e tjera në vlerën e tregut.

### *Zhvlerësimi*

Kompania vlerëson në bazë të rezultateve të parashikuara humbjet e pritura të kreditit të ndërlidhura me instrumentet e saj të borxhit të bartura me koston e amortizuar. Metodologja e zhvlerësimit e aplikuar, varet mbi atë nëse ka pasur ndonjë rritje të konsiderueshme në rrezikun e kredisë.

### *Pronë dhe Pajisjet*

Pasuria dhe pajisjet barten me kosto ose vlerësohen me kosto minus amortizim të akumuluar.

Zhvlerësimi ngarkohet mbi bazën lineare për të shpërndarë koston ose koston e vlerësuar të pasurisë dhe pajisjeve gjatë jetës së tyre të dobishme. Më poshtë janë përafrimet e normave vjetore të zhvlerësimit të aplikuara për zëra të konsiderueshëm të pasurive dhe pajisjeve:

	Si në datën e bilancit
Kompjuterët	20%
Pajisjet tjera	20%
Të paprekshmet	20%

Blerjet pasuese përfshihen në vlerën kontabël të pasurisë ose nijhen si një pasuri e veçantë, sipas rastit, vetëm kur ekziston mundësia e hyrjes së përfitimeve të ardhshme ekonomike për Kompaninë të lidhura me artikullin dhe kur vlera e blerjes së pasurisë mund të matet me besueshmëri. Të gjitha riparimet dhe mirëmbajtjet e tjera ngarkohen në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse si shpenzime gjatë periudhës financiare në të cilën ato ndodhin.

### *Zhvlerësimi i pasurive jo-financiare*

Pasuritë të cilat janë subjekt i zhvlerësimit/amortizimit rishikohen për zhvlerësim kurdo që ngjarja ose ndryshimet në rrethana tregojnë se vlera bartëse mund të mos jetë e rikuperueshme. Vlera bartëse e një pasuri shkruhet menjëherë në shumën e rikuperueshme, atëherë kur vlera bartëse e pasurisë është më e madhe se shuma e rikuperueshme e vlerës së saj. Shuma e rikuperueshme është vlera më e lartë e vlerës së tregut të pasurisë, minus kostot e shitjes dhe vlera në përdorim.

### *Të ardhurat nga interesit*

Të ardhurat nga interesit përfshijnë të ardhurat nga normat e kuponëve të obligacioneve dhe interesit mbi depozitat me afat. Të ardhurat e interesit janë regjistruar në bazë akruale.

**FONDI SLLOVENO KOSOVAR I PENSIONEVE SHA - KOMPANIA**  
**SHËNIMET PËR PASQYRAT FINACIARE PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2019**  
(Vlerat në Euro, përvèç nëse theksohet ndryshe)

**Të ardhurat nga dividenta**

Dividentat njihet në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse atëherë kur përcaktohet e drejta e Fondit për të pranuar pagesën.

**Tarifa e menaxhimit**

Fondi 1 është i detyruar të paguajë tarifën e menaxhimit të Kompanisë në baza mujore. Tarifa vjetore e menaxhmentit është 1.5% e gjithsej pasurisë së Fondit 1.

**Shpenzimet për tarifat e transaksionit**

Këto shpenzime lidhen me tarifën e paguar ndërmjetësuesve financiarë (bankave dhe komisionerëve) të cilët blejnë investime.

**2. Politikat e rëndësishme të kontabilitetit (Vazhdim)**

**Kapitali aksionar**

Kapitali aksionar përfaqëson vlerën nominale të aksioneve të emetuara.

Dividenda e aksioneve të zakonshme njihet në periudhën kur aprovohet nga aksionarët e Kompanisë. Dividendët për vitin kur ato janë botuar, pas datës së bilancit, janë shpalosur në shënimin për ngjarjet e mëvonshme.

**Fitimet / humbjet e realizuara**

